

Cështja	Rekomandimi	veprimi i menaxhmentit (Drejtorisë)	Drejtoria /zyrtari përgjigjes	Data e planifikuar për përfundim			
Plani i Veprimit për eliminimin e të metave të konstatuara nga Raporti i ZKA për Pasqyrat Financiare 2019 të Audituar							
Nr.	Të gjeturat nga Raporti i ZKA për Pasqyrat Financiare 2018 të Audituar	Rekomandimet për eliminimin e të metave nga ZAP	Aktiviteti- Shtator 2020	Aktiviteti- Mars 2021	Zyrtari/ja përgjegjës për eliminimin e të metave	Koha e planifikuar për eliminimin e të metave	Efekti
	Opinion i pamodifikuar Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Baza për opinion Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.	Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmblidhjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësimin dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore. Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.	Ne vitin 2020/2021 dhe do të rishikohet çdo katër muaj (25 Shtator, 12 Janar, 10 Mars, 10 Qershor) nga grupi punues për hartimin dhe përcjelljen e zbatimit të planit të veprimit. Do të mbahen takime të menaxhmentit pas përfundimit të raportit të progresit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA sipas datave të parashkuara më lartë. Raportet e Progresit të datave në ZKA duhet të dorëzohen dy herë brenda vitit 30 Shtator dhe 15 Mars.		Zyrtari/ja përgjegjës për eliminimin e të metave ZKA, ZKF, Zyrtarët Autorizues,	Në vazhdimësi 2020-2021	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
1	Cështja B1 – Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve <i>Planifikimi dhe realizimi i buxhetit</i>	Rekomandimi B1 - Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo nëse paraqitet nevoja të bëhet rideditim i mjeteve sipas kërkesave ligjore. PAGESAT DHE REGJISTRIMI I SHPENZIMEVE TË BËHET SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE ADEKUATE. Gjithashtu obligime e bartura duhet buxhetohen me fondet të mjaftueshme me qëllim të forcimit të disiplinës financiare për pagesën me kohë dhe evitimin e ballafaqimit me drejtësinë duke eliminuar edhe pasojat apo mundësin e shpenzimeve shtesë.	Planifikimi i buxhetit do të bëhet me më shumë kujdes. Pas pranimit të QB3 do të mbahet takim me të gjitha Programet buxhetore të cilët do t'i parashtrijnë kërkesat e tyre buxhetore në të gjitha kategoritë. – të realizimi i buxhetit do të kemi kujdes që të shfrytëzohen mjetet nga të gjitha fondet burimore veçanërisht të investimet kapitale.		ZKA, ZKF, Zyrtarët Autorizues,, Zyra e prokurimit, dhe zyrtari certifikues dhe shpenzues, Komisionet e pranimit dhe mbikëqyrësi.	Dhjetor-2020/21 Data e pacaktuar meqenëse jemi në pritje të QB3. Dhjetor 2020	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
2	Cështja A1 – Mangësi në menaxhimin dhe raportimin e të hyrave <i>Të hyrat</i>	Rekomandimi A1 - Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse me zyrtaren kryesore për të hyrat kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.	Kemi hartuar një plan (tabelë të barazimit) të barazimit të të hyrave në mes zyrtarëve dhe drejtorive përkatëse. Ky plan i është dërguar të gjitha drejtorive dhe barazimi mujor do të aplikohet nga të gjitha drejtoritë.		Zyrtarja e të hyrave dhe të gjithë zyrtarët autorizues dhe personat përgjegjës të caktuar në drejtoritë që janë përcaktuar për barazim me zyrtaren e të hyrave.	Dhjetor-2020-2021 gjatë gjithë vitit	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
3	Cështja A2 – Faturimi i tatimit në pronë dhe zonat komunale <i>Të hyrat</i>	Rekomandimi A2 - Kryetari duhet të sigurojë përditësimin e të dhënave në sistem duke paraqitur zonave tatimore krahas rregullores së aprovuar në kuvendin komunal.	Me departamentin e tatimit në pronë së bashku me zyrtarët e zyrës së Tatimit në Pronë do të kujdesemi që ky rekomandim të zbatohet.		ZKA, ZKF , Drejtori i buxhetit dhe menaxheri i tatimit në pronë.	Dhjetor-2020 2021 Ne proces	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
4	Cështja B2- Shfrytëzimi i pa rregullt i pronave komunale <i>Të hyrat</i>	Rekomandimi B2 - Kryetari duhet të analizojë arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe sigurojë se pronat komunale ofrohen për shfrytëzim vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e planifikuara do të realizohen.	Kryetari i Komunës ka themeluar një Komision i cili do të identifikojë të gjitha pronat e uzurpuara Komunale. Do të bëhet një analizë e sakte mbi statusin e të gjitha pronave komunale të dhëna në shfrytëzim.		ZKA , Drejtorja e urbanizmit, drejtorja e kadastrit, bujgjisë, buxhetit, Drejtorja e inspektionit, zyra ligjore.	20 Tetor 2020 18 Dhjetor 2020	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
5	Cështja B3 – Mbulimi i pozitave të rregullta të punës me kontrata për shërbime të veçanta <i>Mallrat dhe shërbimet</i>	Rekomandimi B3 - Kryetari duhet të sigurojë ndërrëprejen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për pozitave të rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe të njëjtat në vazhdimësi t'i trajtoj dhe diskutoj me MF. Ndërsa në rast të paraqitjes së nevojave për shërbime të veçanta apo punë specifike duhet të sigurojë se për marrëveshjet për shërbime të veçanta	Zbatimi i ligjit për zyrtar publik si dhe akteve nënligjore të miratuara nga niveli qendror që janë në fuqi. Do të bëhet një analizë nga Zyra e personelit lidhur me qësitën në fjalë dhe sipas rezultateve do të ndërmerren hapat e nevojshëm.		ZKA, ZKF, Menaxheri si zyrës së personelit, Menagjeri i zyrës së prokurimit edhe programet tjera buxhetore.	Tetor 2020 (Analiza) Dhjetor 2020 (bugjetimi dhe prokurimi) Tetor 2020 (Analiza) Dhjetor 2020 (bugjetimi dhe prokurimi)	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
6	Cështja A3 – Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve <i>Subvencionet dhe transferet</i>	Rekomandimi A3 - Kryetari të sigurojë se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike përgatitjen vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioritetëve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i eefktivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.	Komuna do të finalizojë draft planin për financimin e OJQ-ve për 2021 si dhe zbatohet Rregullorja e Komunës. Do të përpilohet një shkresë për njoftim lidhur me kërkesën e përplimit të planeve vjetore për subvencionim.		ZKA, ZKF, Zyrtarja Ligjore dhe programet buxhetore përkatëse	Shtator-2020 15 Shtator (shkresa)	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës

7	Çështja B4 – Ndryshimi i sasive të paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimin e ZKA-së kapitale Investimet	Rekomandimi B4- Kryetari duhet të sigurojë se përcaktimi i saktë i nevojave dhe specifikimi i punëve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit dhe në monitorimin e kontratave si organ mbikëqyrës, të përfshihet stafi kompetent që janë të njohur me përgjegjësit e përcaktuar me LPP. Nëse paraqitet nevoja për ndryshim të termave dhe kushteve të kontratës, organi mbikëqyrës duhet të inicioj dhe arsyetoj pranë zyrës së prokurimit këto ndryshime e cila ka përgjegjësin për kontratën dhe marrin aprovimet nga nivelet relevante.	Lidhur me këtë të gjetur do të përgatitet një njoftim/shkresë/ urdhëresë për të gjithë menaxherët e projekteve që kjo e gjetur të mos përsëritet.		ZKA, ZKF , Zyrtari certifikues dhe zyrtari shpenzues, MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT, Menaxheret e projekteve,zyrtarja ligjore	2020	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
8	Çështja A5 - Oferta fituese jo ekonomike Investimet kapitale	Rekomandimi A4 -Kryetari i komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit bëjnë një analizë të detajuar të vlerësimit të nevojave që të arrihet shfrytëzimi sa më ekonomik i fondeve publike.	Nuk do të përsëritet. Për këtë do të mbahet një takim i brendshëm.		Zyra e Prokurimit, MENAXHERI I KONTRATES DHE MBIKEQYRESI	2020	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
9	Çështja B5 - Shpenzime shtesë si pasojë e pagesave përmes vendimeve gjyqësore-përmbartimore Çështjet e përbashkëta	Rekomandimi B5 -Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.	Gjendja është përmirësuar gjatë vitit 2020 dhe do të vazhdohet në këtë formë. Akterët përgjegjës janë informuar lidhur me të gjeturën.		ZKA,ZKF , MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT, Avokati Publik Ligjor Komunal	2020- 2021	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
10	Çështja B6 - Kontrata e nënshkruar në mungesë të fondeve (zotimeve) të mjaftueshëm Çështjet e përbashkëta	Rekomandimi B6 -Kryetari duhet të sigurojë kontrollë shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fonde tjera të financimit.	Do të vazhdohet me përmirësimin e situatës sipas mundësive ashtuqë të mos nënshkruhet kontrata pa zotim të mjetëve. Dhe do të tentohet që të aplikohen kontratat kornizë.		ZKA, ZKF , MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT, Zyrtarët aproves.	2020/2021	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
11	Çështja B7 – Mangësi në regjistrat kontabël të pasurisë Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Rekomandimi B7 Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, të krijojë një sistem efikas të komunikimit dhe raportimit të të dhënave mes drejtorive dhe ZKF-së në mënyrë që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të besueshme për përdoruesit dhe palët e jashtme, të funksionalizojë sistemin e-pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive. Të gjitha këto për menaxhimin e pasurive me qëllim që regjistrat kontabël të paraqesin gjendjen reale të pasurive.	Ka përfunduar regjistrimi i pronave për 2020. Është përpiluar edhe raporti. Janë trajnuar zyrtarët për e-pasuri në arsim dhe shëndetësi.		ZKA, ZYRTARËT AUTORIZUES I ARSIMIT DHE SHENDETËSISE, ZYRTARI I IT, zyrtarja e pasurisë.	Janar 2021 dhe në vazhdimësi	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
12	Çështja B8 – Rritje e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme Të arkëtueshmet	Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbartuesve për rritjen e arkëtimeve.	Komuna ka filluar të dërgojë njoftime: 1 Nëpërmes radios lokale dhe 2. Njoftimeve me shkrim. Janë dërguar disa me shkrim dhe jemi në pritje të përgjigjeve për njoftimet e dërguara. Sipas nevojës do të angazhohet është përmbartuesi privat.		ZKA, ZKF, Menaxherja e tatimit në pronë, zyrtarët aproves dhe drejtoritë përkatëse që kanë të hyra vetanake.	Dhjetor 2020-2021 në vazhdimësi	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës
13	Çështja B9 -Mungesa e raportimit të detyrimeve të papaguara Detyrimet	Rekomandimi B9 -Kryetari duhet të ndërmarrë masa shtesë të respektohet Rregullat financiare nr. 02/2013, që raportimi i detyrimeve të papaguara të bëhet në thesar në baza mujore. Për më tepër të delegohet përgjegjësia të zyrtari i caktuar, i cili do të menaxhoj procesin që nga pranimi i faturës, protokolimin e saj dhe dorëzimi për ekzekutim (pagesë) ndaj furnitorit.	Do të përpilohet një urdhëresë lidhur me çështjen ku nga të gjithë zyrtarët pranues (zyra e kryetarit dhe Kuvendi Komunal) do të kërkohet që të raportohet me kohë për obligimet e papaguara.		ZKA , Zyrtarët Autorizues, certifikues, drejtori për buxhet dhe financa, Zyra Ligjore.	10 Shtator 2020 (përpilimi i urdhëresës)	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës

Çështja		Rekomandimi							
Plani I Veprimit për eliminimin e të metave të konstatuara nga Raporti I ZKA për Pasqyrat Financiare 2016 të Audituara									
Nr.	Të gjeturat nga Raporti I ZKA për Pasqyrat Financiare 2016 të Audituara	Rekomandimet për eliminimin e të metave nga ZAP	Aktiviteti	Zyrtarija përgjegjëse për eliminimin e të metave	Koha e planifluar për eliminimin e të metave	Efekt	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	
1	<p>Theksimi i çështjes</p> <p>Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:</p> <p>□ Vlera neto e pasurisë së regjistruar në SIMFK në vitin 2016 ishte 14,753,930€, ndërsa vlera e shpalosur në PFV ishte 12,494,000€, pra pasuria është nënvlerësuar për 2,259,930€; □ Pasuritë komunale ishin nënvlerësuar si rezultat i mos regjistrimit të 1,540 parcelave komunale në regjistrin kontabël SIMFK; □ Regjistri i e-pasurisë nuk është i saktë për arsye që blerjet kapitale me vlerë nën 1,000€ nga Shëndetësia dhe Arsimi nuk janë përfshirë në këtë regjistrim; dhe □ Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 274,000€. Gjendja përfundimtare e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë e prezantuar në PFV ishte 595,000€, ndërsa vlera e llogarive të arkëtueshme sipas sistemit Protax është 869,000€.</p>	<p>Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Më pas, duhet të ndërmerri veprimet e duhura që të regjistroj të gjitha pasuritë në regjistrat përkatës të pasurive dhe t'i korrigjoj gabimet aktuale në regjistrat kontabël për të siguruar regjistrim të saktë të pasurive dhe shpalosje të plotë llogarive të arkëtueshme.</p>				Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës			
2	<p>Çështja 2 Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë</p>	<p>Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.</p>	<p>Rekomandimet nga viti i kaluar do të adresohen te personat përgjegjës dhe ne afat të caktuar kohor. Auditori i brendshëm të angazhohet për zbatueshmërinë e ketyre rekomandimeve.</p>	<p>ZKA,ZKF,Zyrtarët Autorizues,Menagjeri I Prokurimit,Zyrtari I Pranimit,Zyrtari I Shpenzimeve,Zyrtari Aprovues Qertifikues dhe Auditori i brendshëm .</p>	Dhjetor-2017	Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës			
3	<p>Çështja 3 – Pyetësori i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë</p>	<p>Rekomandimi 3 Kryetari duhet të siguroj se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Auditimi i brendshëm duhet të përfshihet në procesin e rishikimeve përfundimtare për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.</p>				Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës			
4	<p>Çështja 4 – Mungesa e planeve strategjike të zhvillimit dhe planeve tjera - Prioritet i lartë E gjetura Komuna kishte dokumentin për “Strategjinë e zhvillimit rajonal” mirëpo ky dokument i takonte një periudhe të kaluar, viteve 2010-2013. Në vitin 2017 kishte hartuar “Planin kontingjent – fryrjet e erës së fortë dhe vërshimet në Komunën e Istogut”, “Vlerësimin e rrezeve në territorin e Komunës së Istogut” dhe Strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal për Komunën e Istogut për vitin 2017 – 2021. Këto dokumente komuna nuk i posedonte për vitin 2016</p>	<p>Rekomandimi 4 Kryetari duhet të hartoj me kohë dhe propozoj për miratim në asambleen komunale planet strategjike për zhvillimin e komunës duke vendosur, objektiva strategjike dhe duke mbikëqyrur dhe matur realizimin e tyre në baza të rregullta.</p>	<p>Nje dokument zyrtar per identifikimin e rrezeve</p>	<p>Auditori i brendshëm</p>	<p>Korrik-2016</p>	Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës			

5	Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë	Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.	Vendim për raportimin obligativ mujor i Programeve Buxhetore nga zyrtarët Autorizues të ZKA	ZKA ,	Korrik 2016	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
6	Çështja 6 – Mos realizimi i planit të auditimit nga NjAB – Prioriteti i lartë	Rekomandimi 6 Kryetari duhet të punoj me drejtorin e NjAB për të siguruar rishikime të mjaftueshme për vitin aktual mbi sistemet financiare. Në vitet e ardhshme, përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB duhet të monitorohet në baza të vazhdueshme dhe të ndërmerren veprime në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.	Rekomandimet e dhena nga auditimi i brendshëm do të monitorohen me plane të veprimit se bashku me Komitetin e Auditimit do të ngritet përgjegjësia e stafit me personat përkatës përgjegjës . NjAB në kapacitetet që ka ,do të planifikoj që aktivitetin e vet ta ushtrojë për vitin aktual	ZKA ,Drejtorët e Drejtorive ,Auditori brendshëm dhe Komiteti i Auditimit	Janar 2017	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
7	Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë	Rekomandimi 7 Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar apo të rishikuar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Nuk do të përseritet	ZKA,ZKF,,Zyrtari I Pranimit,Zyrtari I Shpenzimeve,Zyrtari Aprovues dhe Qertifikues.	Korik 2016	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
8	Çështja 8 - Dhënia e tokës bujqësore me qira – Prioritet i lartë	Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojë se dhënia me qira e pronës komunale të bëhet konform Rregullores Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.	Nuk do të përseritet	ZKA,ZKF,,Zyrtari I Pranimit,Zyrtari I Shpenzimeve,Zyrtari Aprovues dhe Qertifikues.	Korik 2016	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
9	Çështja 9 - Mos aprovimi me kohë i lejes së ndërtimit – Prioritet i lartë	Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës i shqyrtojnë me kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe i lëshojnë vendimet përkatëse brenda afateve ligjore.				Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		

10	Çështja 10 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave – Prioritet i lartë	Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh udhëzimi administrativ në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.				Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
11	Çështja 11 – Kontratë jashtë planit të prokurimit dhe mungesë zotimi të mjeteve - Prioritet i lartë	Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj që plani i prokurimit është hartuar në bazë të nevojave reale, realizimi bëhet në pajtim me planifikimin dhe fondet e duhura për realizimin e kontratave janë zotuar para nënshkrimit të kontratës.	Nuk do të përseritet	ZKA,ZKF,Zyrtares Autorizues.	Janar -2017	Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
12	Çështja 12 - Lidhja e kontratës me ofertuesin e papërgjegjshëm – Prioritet i lartë	Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë që respektohet ligji dhe kontratat lidhen në pajtim kërkesat në dosjet e tenderit.				Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
13	Çështja 13 – Mos aplikimi i librit ndërtimor – Prioritet i lartë	Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e pagesave të situacioneve të ardhshme për projektet në vazhdim si dhe projektet e reja, të aplikohet libri ndërtimor dhe i njëjti të harmonizohet me situacionet për të verifikuar saktësinë e punëve të kryera dhe shumat e pagesave. Menaxherëve të projekteve t'u qartësohet se aktivitetet e ardhshme duhet të jenë në pajtim me Ligjin e ndërtimit Nr. 04/L – 110) si dhe UA 15/2013 i MMPH mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor.				Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
14	Çështja 14 - Keqklasifikim në kode ekonomike adekuate - Prioritet i lartë	Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e planifikimeve fillestare të buxhetit, shpenzimet të planifikohen, shpenzohen dhe regjistrohen në kategoritë ekonomike adekuate sipas planit kontabël				Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		
15	Çështja 15 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i lartë	Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj që regjistrat e pasurive të jenë të plota dhe të sakta, dhe për dobësitë identifikuar gjatë inventarizimit, të merren veprime konkrete për përmirësim në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurisë.				Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komunës		

16	<p>Çështja 16 - Vonesa në pagesën e faturave dhe mos raportimi në MF - Prioritet i mesëm</p>	<p>Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj që faturat e pranuar të ekzekutohen brenda afatit të paraparë ligjor dhe obligimet e papaguara të raportohen sipas afateve kohore të përcaktuara me rregulloret financiare.</p>				<p>Transparenca .Logaridhenja dhe Performanca e Komonës</p>		
----	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--	-----------------------------------------------------------------------------	--	--

Cështja	Rekomandimi	veprimi I menaxhmentit (Drejtorisë)	Drejtoria /zyrtar	Data e planifikuar për përfundim	
Plani I Veprimit për eleminimin e të metave të konstatuara nga Raporti I ZKA për Pasqyrat Financiare 2017 të Audituar					
Të gjeturat nga Raporti I ZKA për Pasqyrat Financiare 2017 të Audituar	Rekomandimet per eleminimin e të metave nga ZAP	Aktiviteti	Zyrtari,ja përgjegjëse për eleminimin e të metave	Koha e planifikuar per eleminimin e të metave	Efeti
<p>Theksimi i çështjes</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga kategoria e Investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht 116,491€, për projekte të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime si dhe subvencione; Në regjistrin e pasurisë nuk janë regjistruar ende 1,540 parcela të tokës komunale; dhe Regjistri i pasurisë nën 1,000€ (e-pasuria) nuk është përdituar ende me të dhënat e pasurive të viteve paraprake në sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit. 	<p>Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe janë marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve si dhe të shpalojset e pasurisë. Të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël. Me tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.</p> <p>Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollat e nevojshme.</p>	<p>Ne fazen e planifikimit të ndarjeve buxhetore sipas kategorive ekonomike do të jemi të kujdesshem që ti ndajme mjetet në kategori ekonomike sipas akteve ligjore dhe nenligjore të menagjimit të financave publike të Kosovës,</p>	<p>ZKA,ZKF,Zyrtarët Autorizues.</p>	<p>2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>
<p>Çështja 2 - Nivel i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale. Sfidë e mëtuajshme e komunës mbetet niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, në vetëm 76%, duke rezultuar më një deficit prej mbi 600 mijë €. Niveli i ulët i realizimit ishte kryesisht si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Me tutje, një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve ishin realizuar në tremujorin e fundit, të investimet kapitale 63% dhe të mallrat dhe shërbimet 43%.</p>	<p>Rekomandimi 2 Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.</p>	<p>Zyra e prokurimit zhvillon procedura bazuar në planifikimin e prokurimit, por gjithmone me kerkese të njesise kerkuese dhe duke respektuar Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin e prokurimit publik. Asnje kerkese nga asnje njesi kerkuese nuk ka mbet e pa proceduar për aktivitet të prokurimit, ka raste kur me kerkese të njesive kerkuese janë zhvilluar procedura për aktivitetet e prokurimit edhe pas afatit të caktuar me Ligjin për menaxhimin e financave publike (date 31 tetor). Bazuar në planifikimin e prokurimit të cilin e përpilujmë në baze të kerkesave të njesive kerkuese dhe raportit të kontrateve publike, del se në zyre e prokurimit kemi tejkaluar planifikim e prokurimit me numer të aktiviteteve.</p>	<p>ZKA,ZKF,Zyrtarët Autorizues, Menagjeri I Prokurimit, Zyrtari I Pranimit, Zyrtari I Shpenzimeve, Zyrtari Aprovues Qertifikues dhe Auditori i brendhem .</p>	<p>Dhjetor-2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>

<p>Çështja 3 – Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave . Komuna nuk ka bërë verifikimin e 1/3-së të pronave, sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2011 nenit 13. Nga 10,405 prona të evidentuar në bazën e të dhënave mbi tatimin në pronë, komuna ka arrit të verifikoj vetëm 395 prona aktuale të regjistruara, ose vetëm 4%.</p>	<p>Rekomandimi 3 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave të paluajtshme për qëllim të tatimit në pronë duhet të bëhet sipas rregullave, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.</p>	<p>(Vlen të theksohet se për çdo vit verifikohen rreth 1/3 e të gjitha pronave. Evidenca mbahet dhe verifikimi në sistemin e tatimit në pronë bëhet vetëm për pronat që kanë pesu ndryshime. Ndërsa pronat e vizituara, por që nuk kanë pesu ndryshime nuk është mbajtur evidence, e që janë pjesa dermuese e tyre). Brenda këtij viti kalendarik do të mbahet evidence për të gjitha pronat e vizituara në teren, duke përfshirë pronat që kanë pesu ndryshime si dhe pronat që nuk kanë pesu ndryshime, me qëllim të përmbushjes së objektivit ligjor, që është verifikimi i 1/3 –es se pronave .</p>	<p>ZKA,- MenaxherJA e ZKTP ne Istog</p>	<p>Deri me 31.12.</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës</p>
<p>Çështja 4 – Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira.Komuna ka dhënë me qira 6 prona komunale për shfrytëzim të përkohshëm, duke anashkaluar procesin e ankandit publik, si dhe përcaktimi i çmimit të qirasë në këto raste nuk është bërë në përputhje me Rregulloren Nr. 23/2013. Gjatë këtij viti, 36 shfrytëzues të pronës komunale, nuk kanë paguar fare qira dhe komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim për inkasimin e këtyre mjeteve. Për më tepër, në 11 raste kontratat për shfrytëzim të pronës nuk ishin valide, pasi që ka skaduar afati i kontratës. Vetëm në një rast gjatë vitit 2017 është vazhduar kontrata për shfrytëzimin e pronës duke u thirrur në ligjin e vjetër, i cili ishte shfuqizuar kohë më parë.</p>	<p>Rekomandimi 4 Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu duhet të shqyrtohen në mënyra aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.</p>	<p>Komuna ka ndarë buxhet në Programin buxhetor Bujqesia,Pylltaria dhe Zhvillimi Rural në vlerë prej 50,000.00 € në projektin me kod 46268 -Rregullimi I pronave Komunale që të bëhet menaxhimi I dhe shfrytëzimi I duhur I pronave komunale konform rregulloreve dhe Ligjit në fuqi për të siguruar arketimin sa me të madh të të hyrave.</p>	<p>ZKA,Drejtori I Bujqesise dhe Drejtori I Urbanizmit dhe Kadastrit</p>	<p>Dhjetor-2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës</p>
<p>Çështja 5 – Dobësi në angazhimin e stafit sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta .Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12 pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Komuna ka angazhuar 49 zyrtarë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ku janë identifikuar dobësi si në vijim: <input type="checkbox"/> Në 28 raste periudha e angazhimit të zyrtareve është më i gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, mbi gjashtë muaj; <input type="checkbox"/> Në tri raste komuna nuk ka zbatuar ndonjë procedurë të rekrutimit konform kërkesave ligjore; dhe <input type="checkbox"/> Pagesat mujore për këta zyrtar, në asnjë rast nuk kanë të bashkangjitur dëshmi apo raport, për të verifikuar se janë realizuar apo pranuar shërbimet konform kontratës.</p>	<p>Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedurë të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në komunë (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave. Gjithashtu pagesat sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta të realizohen vetëm pasi të sigurohen dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e këtyre shërbimeve</p>	<p>Jemi ne proces te permiresimit</p>	<p>ZKA,ZKF , ZYRTARËT AUTORIZUES, MENAGJERI I PERSONELIT</p>	<p>Dhjetor-2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës</p>
<p>Çështja 6 – Hyrja në obligime pa disponueshmëri të mjeteve buxhetore E gjetura - Komuna ka filluar ndërtimin e 10 shtëpive sipas projektit “Ndërtimi i shtëpive për të pastrehët në Komunën e Istogut”, duke tejkaluar buxhetin në dispozicion prej 95,000€. Kontrata e nënshkruar me 13/07/2017 përcakton vetëm çmimin për njësi/shtëpi në vlerë 10,679€, por nuk specifikon numrin e shtëpive që duhet ndërtuar.</p>	<p>Rekomandimi 6 Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se komuna disponon fondet e mjaftueshme para hyrjes në obligime kontraktuale dhe kërkesat për paramasat dhe paralogaritë janë specifikuar sipas nevojave dhe në përputhje me rregullat e prokurimit.</p>	<p>Per kete aktivitet burim i financimit ka qene buxheti komunale dhe buxheti nga Ministria per Pune dhe Mireqenie Sociale , por per shkak te natyres se aktivitetit numri i shtepive per te pastehe eshte rritur. Pa disponueshmëri te mjeteve buxhetore nuk do te shpallet tender.</p>	<p>ZKA ,ZKF, Menagjeri i zyres se Prokurimit edhe Organizatrat tjera buxhetore</p>	<p>2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komonës</p>

<p>Çështja 7 – Çështja 7 - Mangësi në vendosjen e kritereve tek aktiviteti i prokurimit. E gjetura-Te aktivitetit i prokurimit “Mbikëqyrja e projekteve kapitale” në njoftimin për kontratë të datës 10/03/2017 tek neni III.2.4 kapaciteti teknik dhe profesional, një nga kërkesat ishte që menaxheri i projektit të kishte përvojë pune tre vjeçare. Megjithatë tek dëshmitë e kërkuara nuk ishte specifikuar lloji i dëshmive të kërkuara për të dokumentuar përvojën e punës, prandaj komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave kishte pranuar si dëshmi të përvojës së punës vetëm CV-in, pa siguruar dëshmi të mjaftueshme për të dokumentuar përvojën e punës, si dhe kishte lidhur kontratë më të njëjtin. Si pasojë kontrata ishte lidhur me Operatorin Ekonomik (OE) të pa përgjegjshëm në aspektin e kërkesave të teknike dhe profesionale.</p>	<p>Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë se kontrollë shtesë tek zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit. Fillimisht kriteret e përcaktuara duhet të jenë të qarta, e me pas të komisioni për vlerësim të ofertave të bëjë një vlerësim objektiv në përputhje me to.</p>	<p>Ne baze te Ligjit per prokurim publik, te gjithë operatorët ekonomik te cilet marrin pjese ne nje aktivitet te prokurimit, permes Deklarates NenBetim marrin persiper se jane te përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe mbajne pergjegjsi per cdo dokument ne Dosjen e tyre konkruese, pra CV-ja per ne eshte dëshmi e mjaftueshme per dokumentim lidhur me shkollimin, shkathesit dhe provojen e punes.(Me LPP-ne, Autoriteti kontraktues ka te drejten e verifikimit te te gjitha dokumenteve te cilat jane pjese e dosjes).</p>	<p>ZKA,ZKF ,MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT</p>	<p>Dhjetor 2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>
<p>Çështja 8 - Mosrespektim i procedurës për konfiskimin e sigurisë së tenderit E gjetura - Tek aktiviteti i prokurimit për ndërtimin e rrugës lokale “Selman Tahirsylaj” në fshatin Lluga, komuna nuk ka konfiskuar sigurinë e tenderit nga operatori i cili është tërheq nga tenderimi pasi komisioni vlerësues e kishte rekomanduar për lidhje të kontratës. Vlera e sigurimit të tenderit ishte 3,000€. Pra nuk është përmbushur kërkesa ligjore sipas Udhëzuesit Operativ nenit 29.8 dhe komuna nuk ka ofruar arsye për këtë situatë.</p>	<p>Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojë se kontrollë shtesë për zbatimin e procedurës së konfiskimit të sigurisë së ofertës në rastet e përcaktuara me rregulla dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik.</p>	<p>Operatori ekonomik ka bere kerkese qe te terhiqet nga aktiviteti ne fjale - per shkak te ekzekutimit te shume aktiviteteve te prokurimit ne Autoritetin tone kontraktues dhe per shkake te frikes nga mos permbushja e te gjitha kontratave me nje performance pozitive dhe mos deshimit te projektit ka qene shume korrekt, arsyshem dhe pale e interesit, per kete nuk e kemi pa te arsyshme konfiskimin e sigurimit, rast per te cilin nuk ka perkufizim as me LPP e as me Udhëzues. Nuk do te perseritet.</p>	<p>ZKA,ZKF ,MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT</p>	<p>2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>
<p>Çështja 9 - Nënshkrimi i kontratave pa mbulesë të fondeve për vitin pasues E gjetura - Në dy raste komuna ka nënshkruara kontrata në fund të vitit pa fonde të buxhetuara edhe për vitet e ardhshme. Kontratat: “Asfaltimi i rrugës lokale Selmon Tahirsyla, fshati Lluga” me 29/11/2017 me plan dinamik 60 ditë, si dhe “Betonimi i kanalit të ujitjes Vrell – Prigode” me 13/11/2017 me plan dinamik 50 ditë pune. Në përputhje me kërkesat e Ligjit të Buxhetit nuk lejohet nënshkrimi i kontratave në fund vit për projekte, shpenzimet e të cilave pritet të behën në vitin e ardhshëm. Përrjashtim bëjnë vetëm rastet kur buxheti për një projekt të tillë është planifikuar edhe për vitet e ardhshme.</p>	<p>Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë se komuna merr obligime kontraktuale konform fondeve të buxhetuara vjetore dhe sipas rregullave. Kontrollët adekuate duhet të funksionojnë para nënshkrimit të kontratave e sidomos në periudhën e fund vitit.</p>	<p>Nuk do të perseritet</p>	<p>ZKA,ZKF ,MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT</p>	<p>2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>
<p>Çështja 10 - Mosrespektim i legjislacionit përkatës në formimin e komisioneve të vlerësimit. E gjetura- Komuna e Istogut në fillim të vitit 2017 ka aprovuar një listë të stafit prej 20 anëtarësh të cilët janë angazhuar sipas nevojës në komisione të ndryshme, qoftë të hapjes apo vlerësimit pa ndonjë vendim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Sipas nenit 40 të rregullës dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik, komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast nga Zyrtari Kryesor Administrativ me rekomandim nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.</p>	<p>Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit komisionet përkatëse formohen prej rastit në rast me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, në përputhje me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik</p>	<p>Nuk do te perseritet</p>	<p>ZKA,ZKF ,MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT</p>	<p>2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>

<p>Çështja 11 – Pagesa pa dëshmi të mjaftueshme E gjetura - Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur se në dy (2) rastet në vijim ishin realizuar pagesa pa siguruar dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve:</p> <p><input type="checkbox"/> Pagesa në vlerë 638€, për “Krijimin e sistemit të unifikuar të adresave në komunën e Istogut” është realizuar pa dëshmi për realizimin e shërbimeve; dhe</p> <p><input type="checkbox"/> Pagesa në vlerë 15,000€ për “Mirëmbajtjen e rrugëve lokale të rendit të katërt në Komunën e Istogut” është realizuar bazuar në raportin e përgatitur nga komisioni për punët e kryera, sipas të cilit kompania ka bërë shtrimin e rrugëve me zhavorr në lokalitete të ndryshme të komunës, por nuk tregohet saktësisht se cilat rrugë si dhe sasinë e punëve të realizuara</p>	<p>Rekomandimi 11 Kryetari duhet të forcojë kontrollin në procesin e pagesave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara.</p>	<p>Nuk do te perseritet</p>	<p>ZKA,ZKF ,MENAGJERI I ZYRES SE PROKURIMIT ,Zyrtari çertifikues</p>	<p>2018</p>	<p>Transparenca .Llogaridhenja dhe Performanca e Komunës</p>
